

PROCESVERBAL
nga seanca e dymbëdhjetë e Këshillit të Agjencisë për Shërbime
Mediatike Audio dhe Audiovizuale
mbajtur më 26.9.2025

Anëtarët e Këshillit të Agjencisë të pranishëm nëpërmjet lidhjes video-konferencë: mr. Sasho Stefanovski, mr. Zirjeta Jajaga, Gordana Majnova, Afrona Vërzivolli, Cvetanka Minovska, Petar Xhurovski, Viktor Pavlovski.

Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: /

Në seancë nëpërmjet lidhjes video-konferencë ishte i pranishëm dhe dr. Zoran Trajčevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Punonjësit nga shërbimi profesional të pranishëm nëpërmjet lidhjes video-konferencë: mr. Dragica Ljubevska, Maja Damevska, mr. Emilija Janevska, Cvetanka Mitrevska, mr. Ruzhica Boshnakoska-Jotevska, dr. Ivana Stojanovska, Sergej Todorovski.

Të pranishmit e tjerë: /

Kryetari i Këshillit, mr. Sasho Stefanovski, hapi seancën e dymbëdhjetë të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale. Seanca filloi në ora 9:30 dhe u mbajt nëpërmjet lidhjes video-konferencë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi si vijon:

RENDIN E DITËS

1. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga seanca e njëmbëdhjetë të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 24.9.2025.
2. Propozim-udhëzim për transmetuesit për Zgjedhjet Lokale 2025.
3. Të ndryshme.

Pika 1

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi dhe njëzëri miratoi Procesverbalin nga seanca e njëmbëdhjetë të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 24.9.2025, me tekstin e propozuar.

Pika 2

Drejtori i Agjencisë, dr. Zoran Trajčevski, shpjegoi Propozim-udhëzimin për transmetuesit për Zgjedhjet Lokale 2025. Ai kujtoi se Draft-udhëzimi u miratua nga Këshilli më 24 shtator 2025 dhe menjëherë pas kësaj u publikuan në ueb-faqe të Agjencisë, në mënyrë që të gjitha palët e interesuara të mund të paraqisnin vërejtjet e tyre. Afati i fundit për komente ishte 25 shtatori 2025, dhe Agjencia mori dy ankesa - një nga Televizioni Sitel dhe një nga partia politike Levica. Dr. Trajčevski theksoi se të dy ankesat janë plotësisht të papranueshme, pasi janë në kundërshtim me Kodin Zgjedhor. Ankesa nga Televizioni Sitel i referohet pikës 7 të Udhëzimit, ku televizioni kërkoi të lejonte transmetimin e më shumë RPP për pjesëmarrës të caktuar në rast të "gabimi teknik", pa u llogaritur kjo si shkelje. Drejtori theksoi se një

kërkesë e tillë nuk mund të pranohet sepse në praktikë është e pamundur të përcaktohet nëse është gabim apo lëshim i qëllimshëm. Ai kujtoi se në ciklet e kaluara zgjedhore ka pasur raste që radiodifuzerë të transmetojnë reklama politike jashtë planit mediatik, jo vetëm për disa sekonda, por edhe për shumë më tepër. Prandaj, çdo rast i tillë në vitin 2025 do të shqyrtohet individualisht, për të përcaktuar nëse është vërtet gabim teknik apo shkelje e Ligjit. Lidhur me ankesën e partisë politike Levica, i referohet pikave 3 dhe 10 të Udhëzimit. Të dy propozimet u refuzuan. Dr. Trajčevski kujtoi se neni 75-gj, paragrafi 1 i Kodit Zgjedhor përcakton qartë se dy partitë më të mëdha në pushtet dhe dy partitë më të mëdha në opozitë marrin në maksimum katër minuta për RPP, dhe shpërndarja nga 4 minuta midis tyre kryhet me marrëveshje të ndërsjellë. Miratimi i propozimit të Levicës do të thoshte dalje jashtë kornizës ligjore. Lidhur me pikën 10, e cila i referohet mundësisë që një parti ose koalicion i caktuar të mbështesë kandidat që nuk është pjesë e një koalicioni ose është kandidat i pavarur, ai sqaroi se kjo praktikë ka qenë e pranishme dhe në ciklet e mëparshme zgjedhore dhe nuk paraqet një risi. Ankesë të njëjtë Levica pati dhe në vitin 2021, kur u shqyrtua nga Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit dhe u refuzua si e pabazuar. Për të gjitha arsyet e deklaruara, Drejtori propozoi që Këshilli i Agjencisë të miratojë Propozim-udhëzimin në të njëjtën formë si Draft-verzioni.

Këshilltarja Cvetanka Minovska pyeti nëse ka tolerancë kohore në lidhje me gabimet teknike gjatë transmetimit të reklamimit të paguar politik (RPP), përkatësisht nëse ekziston një limit i lejuar në sekonda që do të llogaritej për gabim ose nëse nuk lejohet ndonjë tejkalim i kohëzgjatjes së planifikuar.

Drejtori i Agjencisë, dr. Zoran Trajčevski, konfirmoi se situata të tilla kanë ndodhur vërtet në ciklet e kaluara zgjedhore. Ai shpjegoi se partitë politike paraqesin spote me gjatësi të caktuar, për shembull një minutë e 30 sekonda, por kur transmetohen ato mund të zgjasin një minutë e 37 sekonda. Në këtë mënyrë, blloku prej katër minutësh për RPP mund të tejkalohet për shtatë sekonda. Trajčevski theksoi se në raste të tilla, kur situata përsëritet gjatë ditës, Agjencia reagon duke treguar dhe radiodifuzerët menjëherë e ndërpresin transmetimin dhe bëjnë korrigjim. Në rrethana të tilla, është e qartë se bëhet fjalë për gabim teknik. Megjithatë, nëse radiodifuzer transmeton spot prej shtatë minutësh, kjo nuk mund të trajtohet si gabim, sepse Ligji përcakton në mënyrë strikte që njëra parti nuk mund të marrë më shumë se katër minuta, përveç nëse ka marrëveshje me parti tjetër për lëshimin e pjese të kohës. Ai shtoi se, megjithëse ligji nuk parashikon tolerancë për tejkalimin e sekondave ose minutave të lejuara, kur është e qartë se bëhet fjalë për gabim teknik të paqëllimshëm, Agjencia vjen në ndihmë. Ai arriti në përfundim se çdo rast do të shqyrtohet individualisht, sepse nuk mund paraprakisht të përcaktohet nëse do të tolerohen dy, tre apo dhjetë sekonda, ajo që është e rëndësishme është nëse është e qartë se bëhet fjalë për gabim teknik të paqëllimshëm apo për shkelje të Ligjit.

Kryetari i Këshillit, Stefanovski, arriti në përfundimin se Agjencia do të vijë në ndihmë në situatat kur është e qartë se ka gabim teknik. Ai theksoi se do të ketë mirëkuptim për radiodifuzerët gjatë transmetimit të RPP gjatë zgjedhjeve të ardhshme lokale.

Këshilltari Viktor Pavlovski shtroj pyetje nëse Këshilli do të votonte veçmas për propozimet e paraqitura nga Televizioni Sitel dhe partia politike Levica.

Drejtori dr. Zoran Trajčevski shpjegoi se votim i tillë është i mundur vetëm nëse ndonjëri nga anëtarët e Këshillit deklaron se pranon ndonjë nga dy propozimet. Në atë rast, kryetari do ta vërë propozimin në votim, pas së cilës do të shihet nëse do të mbështetet nga

shumica dhe do të përfshihet në udhëzim. Ai shtoi se shërbimi profesional i Agjencisë, përkatësisht sektori juridik, tashmë ka vlerësuar se propozimet e Sitel dhe Levica janë në kundërshtim me Ligjin, dhe për këtë arsye Agjencia propozon që Udhëzimi të miratohet në tërësi, pa ato ndryshime, nëpërmjet një votim.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Udhëzimin për radiodifuzerët për Zgjedhjet lokale 2025, me tekstin e propozuar.

Spektori për mbështetjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, udhëzimin e lartpërmendur ta publikojë në ueb-faqe të Agjencisë dhe me postë elektronike t'ua dërgojë të gjithë radiodifuzerëve.

Pika 3

Të ndryshme

Nuk kishte diskutim nën "Të ndryshme".

Përktheu: Antoneta Shabani

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
Mr. Sasho Stefanovski**